

# **RREGULLORJA E KONSOLIDUAR PËR MËNYRËN, LLOJIN DHE SHUMËN E SUBVENCIONEVE**

Rregullorja për mënyrën, llojin dhe shumën e subvencioneve (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 53/13, 147/14, 50/15 dhe 32/16)

## **Dispozitat e përgjithshme**

### **Neni 1**

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra, lloji dhe shuma e subvencioneve të qarkullimit të huaj të organizuar turistik.

### **Neni 2**

(1) Me qëllim të nxitjes së qarkullimit të huaj të organizuar turistik, operatorët turistikë dhe agjencitë turistike (në tekstin e mëtejshëm: organizatorët) mund të fitojnë subvencione për qëndrimin e turistëve të huaj në Republikën e Maqedonisë për një pjesë të harxhimeve për transportin e realizuar të organizuar ajror, rrugor dhe hekurudhor turistik në vitin aktual (në tekstin e mëtejshëm: subvencionet).

(2) Për operatorë turistikë dhe agjenci turistike të paragrafit (1) të këtij neni nuk konsiderohen subjekte të nenit 6 të Ligjit për veprimtarinë turistike.

### **Neni 3**

(1) Subvencione mund të fitojnë organizatorët e pakos së aranzhimeve për turistë të huaj (në tekstin e mëtejshëm: Programi), i cili përfshin:

- Qëndrimin në Maqedoni me të paktën tri bujtje të realizuara me mëngjes, në kapacitete për akomodim të cilat kanë një vendim të vlefshëm për kategorizim (në tekstin e mëtejshëm: kapacitete të kategorizuara për akomodim);
- Transportin e organizuar grupor, me autobusë, aeroplanë dhe trena të rezervar posaçërisht, ose të paktën dhjetë vende të rezervuara në automjetet e cekura transportuese, nga vendi i nisjes së grupit deri në vendin e përdorimit të shërbimit në objektin akomodues dhe kthimi i grupit në të njëjtin relacion (udhëtimi me autobus, aeroplan dhe tren gjatë qëndrimit në Maqedoni nuk është përfshirë);
- Transportin e organizuar grupor me linja të rregullta ajrore ose transportin e rregullt hekurudhor ose me autobus me ardhjen dhe kthimin e grupit (të paktën dhjetë persona në grup);
- Turneun e kombinuar – transporti i organizuar grupor në kombinim me dy automjete transportuese, si automjete kryesore transportuese (aeroplan, autobus ose tren), me ç'rast automjeti transportues me ardhjen e tij në ndonjë destinacion të caktuar konsiderohet për automjet kryesor dhe për të parashtrohet një kërkesë dhe

- Turne rrethore (me minimum një bujtje në një vend të tretë) të cilat organizohen në vendet e rajonit (të paktën dhjetë persona në grup) me një transport të organizuar gjatë nisjes dhe shkuarjes së avionit, autobusit apo trenit, nëse realizohen të paktën dy bujtje me shërbimin e bujtjes me mëngjes në Republikën e Maqedonisë.

(2) Nëse më shumë organizatorë të udhëtimit përdorin të njëjtin automjet transportues, që është rezervuar tërësisht, një kërkesë për subvencion mund të parashtrojë organizatori i cili është qiramarrës, kështu që do të parashtrojë dokumentacionin e tërësishëm të të gjithë organizatorëve.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, një kërkesë për subvencion mund të parashtrojë çdo organizator veç e veç me një pëlqim me shkrim nga organizatori që ka rezervuar tërësisht automjetin transportues.

## **KËRKESA DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR SUBVENCIONE PËR NJË LLOJ TË VEÇANT TË TRANSPORTIT**

### **Neni 4**

Për marrjen e subvencioneve nga neni 2 i kësaj rregulloreje, organizatorët dorëzojnë:

#### **1) Për transportin me autobus:**

- Kërkesa për subvencionimin e programit të pushimeve në qarkullimin e huaj rrugor turistik me autobus në Formularin SU -1, i cili është dhënë në Aneksin 1 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje;
- Kopja e udhëzimit të udhëtimit për transportin me autobus, kopje e faturës së transportuesit me të dhëna të dukshme për vendin e nisjes dhe arritjes së grupit dhe datën së transportit të kryer;
- Prova për faturën e paguar për transportin e realizuar (kopja e virmanit ose bilancit bankar)

#### **2) Për transportin me aeroplan:**

- Kërkesa për subvencionimin e programit të pushimeve në qarkullimin e huaj ajror turistik në Formularin SU -2, i cili është dhënë në Aneksin 2 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje;
- Kopja e kontratës me transportuesin ajror për rezervimin e aeroplanit, nga e cila shihen të dhënat për: numrin e ulëseve në aeroplan, vendin e nisjes dhe arritjes së aeroplanit, numrin e fluturimeve të planifikuara;
- Kopja e raportit ditor të fluturimeve në aeroportet vendore si dhe një vërtetim për arritjen e kryer të fluturimeve charter;
- Kopja e kontratës ose ofertës së transportuesit ajror ose fatura ose fotokopja e faturës të transportuesit ajror ose kopja e biletës së aeroplanit të linjave të rregullta;
- Lista e fluturimit me turistët e shënuar të huaj dhe përcaktimi i saktë i kapacitetit akomodues, për të cilët parashtrohet kërkesa për subvencion;
- Prova për faturën e paguar për transportin e realizuar dhe

- Fatura me të dhëna të dukshme për periudhën dhe relacionin e lëvizjes së grupit nga transportuesi vendas dhe prova për pagesën e saj, nëse programi i aranzhimit përfshin udhëtimin nëpër vende të ndryshme në Maqedoni

### **3) Për transportin hekurudhor:**

- Kërkesa për subvencionimin e programit të pushimeve në qarkullimin e huaj hekurudhor turistik në Formularin SU-5, i cili është dhënë në Aneksin 5 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje dhe
- Kopja e kontratës me hekurudhën për rezervimin e vagonit;
- Lista e të dhënave për turistët e huaj për të cilët parashtrohet kërkesa dhe
- Prova për faturën e paguar për transportin e realizuar.

### **4) Për turne të kombinuara në Maqedoni dhe turne rrethore në rajon:**

- Kërkesa për subvencionim për turne të kombinuara dhe turne rrethore në rajon në Formularin SU-6, i cili është dhënë në Aneksin 6 dhe është pjesë e kësaj rregulloreje;
- Vërtetimi për grupin për të cilin ka të bëjë kërkesa me të dhëna të dukshme për udhëtarët dhe periudhën e qëndrimit, të verifikuar nga ana e partnerit të huaj.
- Kopja e kontratës me agjencinë turistike të Maqedonisë ose vërtetimi për turne nga një agjenci e huaj me një agjenci turistike të Maqedonisë, ku duhet të shihet nëse agjencia turistike e Maqedonisë punon në emër dhe për llogari të agjencisë së huaj ose është organizator i cili ia shet programin një agjencie të huaj;
- Lista e autobusit me të dhëna të dukshme për turistët e huaj dhe kalimet kufitare dhe
- Fatura me të dhëna të dukshme për periudhën dhe relacionin e lëvizjes së grupit dhe prova për pagesën e saj.

## **Neni 5**

Organizatorët të cilët kërkojnë të fitojnë subvencione, deri në Agjencinë për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit të Republikës së Maqedonisë, përveç kërkesës dhe dokumentacionit për secilin lloj të veçantë të transportit, në përputhje me nenin 4 të kësaj rregulloreje, e dërgojnë edhe këtë dokumentacion:

- Programi për aranzhimin konkret për të cilin parashtrohet kërkesa për subvencion;
- Licenca A për parashtruesin e kërkesës ose licenca për veprimtarinë e operatorit turistik;
- Kopja e kontratës së qiramarrjes me kapacitetin e kategorizuar akomodues, të lidhur para ose në momentin e fillimit të qëndrimit të turistëve të huaj dhe kopja e vendimit për kategorizim, me vlefshmëri për periudhën e akomodimit të grupit.
- Lista e verifikuar e turistëve të huaj - lista e dhomave ose specifikimi i mysafirëve;
- Kopja e faturave të të gjitha kapaciteteve akomoduese në vend në të cilat kanë qëndruar mysafirët gjatë gjithë kohës së realizimit të programit të subvencionuar, me provë për faturën së paguar (kopja e virmanit apo bilancit bankar);
- Kontrata shtesë me një objekt të regjistruar për kryerjen e veprimtarinë hotelierike (nëse shërbimi i bujtjes me mëngjes është ndarë), kopja e faturës me të dhëna të dukshme për periudhën, sasinë dhe llojin e shërbimit të kryer dhe prova për faturën e paguar nga objekti hotelierik (kopja e virmanit ose bilancit bankar);
- Për secilin grup është e nevojshme të dorëzohet edhe një provë për taksën e paguar turistike (bilanc bankar ose virman) të verifikuar nga objektet akomoduese, në formularin SU-4, i cili është dhënë në Aneksin 4 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, ndërsa

për turistët e huaj për të cilët akomodimi është rezervuar nga një agjenci turistike e Maqedonisë në objekte akomoduese të llojit të dhomës dhe apartamenteve nga persona fizikë, në Formularin SU-4, i cili duhet të verifikohet nga ana e byrosë turistike/agjencisë turistike në vendin ku kanë qëndruar turistët (nëse ekziston);

- Te programet më të mëdha për transportin ajror ose rrugor në vend të listës së verifikuar të turistëve të huaj dërgohet lista e fluturimit apo lista e hotelit, e verifikuar nga ana e objektit akomodues apo agjencia turistike e Maqedonisë, për të cilën gjë dorëzohet një provë se të gjitha obligimet janë kryer, virman i verifikuar dhe kopje e bilancit bankar dhe

- Bilanci i bankës për të ardhurat devizore për operatorët, agjencitë e huaja turistike apo organizatorët e udhëtimit pas pagesës së kryer.

## **MËNYRA E SUBVENCIONIMIT**

### **Neni 6**

(1) Afatet për parashtrimin e kërkesave për marrjen e subvencionit të cilat parashtrohen në Agjencinë për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit të Republikës së Maqedonisë janë:

- 60 ditë pas shkuarjes së grupit për të gjitha llojet e kërkesave për periudhën prej 01.01. deri më 30.09. në vitin aktual dhe

- 30 ditë pas shkuarjes së grupit për të gjitha llojet e kërkesave për periudhën prej 01.10. deri më 31.12. në vitin aktual.

(2) Për kërkesat që janë dërguar me dokumentacion jo të plotë, organi që zhvillon procedurën, dërgon një njoftim deri të kërkuesi duke përcaktuar afatin për plotësimin e kërkesës dhe nëse pala nuk vepron në përputhje me njoftimin, kërkesa refuzohet.

(3) Kërkesat të cilat janë dërguar pas skadimit të afateve të paragrafit (1) të këtij neni, refuzohen.

## **MBULIMI DHE PERIUDHA E SUBVENCIONIMIT**

### **Neni 7**

Subvencioni zbatohet për të gjitha programet e nenit 3 të kësaj rregulloreje dhe nisjet e realizuara për:

- a) gjithë periudhën e realizimit të programit dhe
- b) për turnet rrethore gjatë gjithë vitit.

## **SHUMA E SUBVENCIONEVE PËR TRANSPORTIN ME AUTOBUS**

### **Neni 8**

(1) Subvencioni mund të fitohet vetëm për autobusin e rezervuar paraprakisht ose për minimum dhjetë vende të rezervuara në linjat e rregullta për realizimin e programit të nenit 3 të këtij udhëzimi, edhe atë për:

a) Shqipërinë, Bullgarinë, Serbinë, Kosovën, Greqinë, Malin e Zi, Bosnjën dhe Hercegovinën:  
- 10 euro në kundërvlerë të denarit për një turist të huaj

b) Turqinë, Rumaninë, Hungarinë, Slloveninë, Kroacinë:  
- 15 euro në kundërvlerë të denarit për një turist të huaj

c) Të gjitha vendet e tjera:  
- 20 euro në kundërvlerë të denarit për një turist të huaj

(2) Për vozitjen me furnizim, vozitjen e autobusit pa udhëtarë nga vendi i nisjes së grupit dhe vozitjen gjatë qëndrimit në destinacion, nuk merren subvencione.

(3) Subvencioni nuk mund të merret për transporte me autobus nga aeroportet deri te objektet akomoduese.

## **SHUMA E SUBVENCIONEVE PËR TRANSPORTIN AJROR**

### **Neni 9**

(1) Subvencion për transportin me aeroplan të një turisti të huaj organizatori mund të fitojë me rezervimin e një aeroplani në tërësi, një pjesë të aeroplanit ose për të paktën dhjetë turistë të huaj që udhëtojnë me një linjë të rregullt ajrore.

(2) Shuma e subvencionit pas arritjes së një turisti të huaj është:

a) nga destinacionet evropiane (së bashku me Turqinë), përveç për vendet e Beneluksit, Finlandën, Norvegjinë, Danimarkën, Suedinë, Anglinë, Gjermaninë, Rusinë, Ukrainën, Izraelin, Austrinë, Italinë, Francën, Spanjën, Çekinë, Sllovakinë, Hungarinë, Poloninë dhe Rumaninë, 25 Euro në kundërvlerë të denarit.

b) për vendet e Beneluksit (Belgjika, Holanda, Luksemburgu), Finlandën, Norvegjinë, Danimarkën, Suedinë, Rusinë, Ukrainën, Emiratet e Bashkuara Arabe, Kinën, Indinë, Gjermaninë, Anglinë, Kazakistanin, Azerbajxhanin, Katarin, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japoninë, Izraelin, Austrinë, Malajzinë, Korenë Jugore, Italinë, Francën, Spanjën, shuma e subvencionit është 65 euro në kundërvlerë të denarit.

c) për Çekinë, Sllovakinë, Hungarinë, Poloninë dhe Rumaninë, 35 euro në kundërvlerë të denarit dhe

ç) nga destinacionet interkontinentale, 45 euro në kundërvlerë të denarit. (Këtu e konsiderojmë edhe Izraelin).

(3) Shuma e subvencionit për një turist të huaj të ardhur nga Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Shqipëria, Kosova dhe Bullgaria, me të paktën katër bujtje të realizuara me mëngjes, është 35 euro në kundërvlerë të denarit.

## SHUMA E SUBVENCIONEVE PËR TRANSPORTIN ÇARTER

### Neni 10

(1) Për aranzhimet sipas programeve të nenit 3 të kësaj rregulloreje, për çarterë, subvencioni është 25 euro në kundërvlerë të denarit për një turist të huaj të ardhur në të gjitha aeroportet në Republikën e Maqedonisë.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, për vendet e Beneluksit (Belgjika, Holanda, Luksemburgu), Finlandën, Norvegjinë, Danimarkën, Suedinë, Rusinë, Ukrainën, Emiratet e Bashkuara Arabe, Kinën, Indinë, Gjermaninë, Anglinë, Kazakistanin, Azerbajxhanin, Katarin, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Japoninë, Izraelin, Austrinë, Malajzinë, Korenë Jugore, Italinë, Francën dhe Spanjën, shuma e subvencionit është 65 euro në kundërvlerë të denarit.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, shuma e subvencionit për një turist të huaj të ardhur nga Çekia, Sllovakia, Hungaria, Polonia dhe Rumania, me të paktën tri bujtje të realizuara me mëngjes, është 35 euro në kundërvlerë të denarit.

(4) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, shuma e subvencionit për një turist të huaj të ardhur nga Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Bullgaria, me të paktën katër bujtje të realizuara me mëngjes, është 35 euro në kundërvlerë të denarit.

(5) Për zinxhirin e fluturimeve çarter, me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, mund të miratohet transporti i grupit të parë gjatë ardhjes, përkatësisht të grupit të fundit gjatë shkuarjes dhe agjencia mund ta organizojë me një automjet tjetër transportues, me ç'rast për atë grup fitohet një subvencion në vlerë prej 15 eurosh në kundërvlerë të denarit për një turist të huaj të ardhur.

(6) Subvencioni për fluturimin çarter fitohet edhe për turistë të huaj të cilët kanë organizuar qëndrim në objektet akomoduese të paktën tri ditë me shërbimin e bujtjes me mëngjes.

(7) Subvencion për fluturimin çarter mund të fitojnë vetëm organizatorët të cilët do ta organizojnë fluturimin çarter në rrezikun e tyre. Nëse fluturimin çarter e organizon një kompani e huaj ajrore në rrezikun e saj, ndërsa organizatorët e udhëtimeve rezervojnë një pjesë të fluturimit çarter, subvencionin mund ta fitojnë vetëm nëse për të paktën dhjetë vendet e rezervuara ka një pako aranzhimi me qëndrim të paktën tri ditë me shërbimin e bujtjes me mëngjes, e nuk do të mund të fitojë kompania ajrore.

(8) Nëse më shumë organizatorë e përdorin të njëjtin çarter fluturim, kërkesën për subvencion e parashtron organizatori që ka rezervuar fluturimin me dokumentacionin e tërësishëm të të gjithë organizatorëve.

(9) Me përjashtim të paragrafit (7) të këtij neni, kërkesën për subvencion mund ta parashtrijë çdo organizator veç e veç me një pëlqim me shkrim të organizatorit, i cili ka rezervuar charter fluturimin në tërësi.

(10) Kërkesa për subvencion parashtrihet për çdo destinacion/aeroport dhe çdo fluturim. Në rast se nuk ka mundësi për të ateruar aeroplani në aeroportin e dakorduar për shkak të arsyeve teknike apo arsyeve të tjera të arsyeshme, do të pranohet aterimi në aeroportin më të afërt me provën për arsyet për ndryshimin e aeroportit. Për fluturimin e fundit pa udhëtarë nuk mund të fitohet subvencion.

## **SHUMA E SUBVENCIONEVE PËR TRANSPORTIN HEKURUDHOR**

### **Neni 11**

(1) Për transportin hekurudhor, shuma e subvencionit është 15 euro në kundërvlerë të denarit për një turist të huaj të ardhur.

(2) Subvencion mund të fitohet për një tren të tërë të rezervuar (çarter), për një vagon të rezervuar ose minimum dhjetë vende të rezervuara në linjën e rregullt të trenit. Kërkesat për subvencione parashtrihen për çdo destinacion dhe çdo udhëtim.

(3) Subvencion gjithashtu mund të fitohet edhe për transporte me autobus nga stacioni hekurudhor deri te kapaciteti akomodues nëse kapaciteti akomodues gjendet në qytet në të cilin nuk ka stacion hekurudhor.

## **SHUMA E SUBVENCIONEVE PËR TRANSPORTIN E KOMBINUAR**

### **Neni 12**

(1) Për turnetë e kombinuara që përfshijnë transportin ajror gjatë arritjes në destinacion, shuma e subvencionit është 15 euro në kundërvlerë të denarit për një turist të huaj të ardhur.

(2) Për turnetë e kombinuara që përfshijnë transportin me autobus gjatë arritjes në destinacion, shuma e subvencionit është 10 euro në kundërvlerë të denarit për një turist të huaj të ardhur.

## **SHUMA E SUBVENCIONEVE PËR TURNETË RRETHORE NË RAJON**

### **Neni 13**

(1) Organizatori mund të fitojë subvencion për turne të organizuara grupore rrethore në rajon (minimum dhjetë persona në grup) për turistët e huaj të cilët vijnë në Republikën e Maqedonisë me autobus ose aeroplan, përkatësisht në Republikën e Maqedonisë do të realizojnë të paktën dy bujtje me mëngjes në turnetë rrethore me qëndrim në Republikën e

Maqedonisë. Turnetë rrethore në rajon duhet të përfshijnë të paktën një bujtje në një vend tjetër të rajonit.

(2) Shuma e subvencionit të paragrafit (1) të këtij neni është 15 euro në kundërvlerë të denarit për një turist të huaj të ardhur.

(3) Për turnetë rrethore organizatori nuk mund të fitojë subvencion në bazë tjetër të kësaj rregulloreje.

## **PAGESA SUBVENCIONEVE**

### **Neni 14**

Subvencioni llogaritet në denarë. Pas refuzimit të harxhimeve bankare, Agjencia për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit në Republikën e Maqedonisë shumën e subvencionit të llogaritur në denarë ia paguan organizatorit në llogarinë e tij jashtë vendit në valutën nacionale në vendin në të cilën organizatori ka selinë, përkatësisht me urdhër të organizatorit.